

FUNKSIONI 8: ARGËTIMI, KULTURA DHE FEJA

Programi 08130: Sport dhe argëtim

Përmbajtja

HYRJE.....	2
1. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT 08130.....	2
2. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E POLITIKËS SË PROGRAMIT.....	5
3. PLANI I SHPENZIMEVE TË PRODUKTEVE TË PROGRAMIT	7
4. PROJEKTET E INVESTIMEVE TË PROGRAMIT	10
5. TË DHËNA MBI PROGRAMIN.....	12
6. PROJEKTET E PLANIFIKUARA PËR PBA 2022-2024	14

HYRJE

1. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 08130

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Programi mbulon operimin ose mbështetjen e strukturave për aktivitete çlodhëse dhe sportive dhe kontribut financiar për promovimin e sporteve.		
08130	Sport dhe argëtim	<ul style="list-style-type: none">• Vënie në funksionim ose mbështetje e strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive aktive; mbështetje për ekipet përfaqësuese vendore në veprimtaritë sportive.• Vënie në funksionim ose mbështetje e strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive pasive (struktura për qëndrimin e spektatorëve; sidomos vende të pajisura për lojëra me letra, lojëra me tabelë etj.)• Grante, hua ose financime për të mbështetur ekipe ose konkures apo lojtarë individualë

Gjatë vitit 2021 situata pandemike Covid- 19 ka qenë faktori që ka penguar realizimin e stërvitjeve të sportistëve në ambientet e mbyllura gjatë periudhës janar - prill, aktiviteteve sportive dhe të kampionateve sportive sipas disiplinave. Gjatë gjithë kohës, sportistët kanë shfrytëzuar hapësirat e jashtme për realizimin e stërvitjes së tyre në mënyrë që të mbajnë formën e tyre sportive. Të gjitha hapësirat e jashtme të objekteve sportive të Bashkisë Shkodër janë shfrytëzuar, dhe kryesisht stadiumi “Loro Borici”. Stërvitja në këto hapësira u ndërtua mbi bazën e një orari stërvitor të mirëpërcaktuar për çdo disiplinë sportive. Gjatë muajve të verës stërvitjet kanë vazhduar rregullisht si në ambiente të hapura ashtu dhe ambiente të mbyllura. Bashkia Shkodër, në zbatim të Ligjit 79/2017 “Për sportin”, i ndryshuar, ka paraqitur në Këshill Bashkiak relacionin dhe projekt vendimin për mbylljen e institucionit “Sport Klub Vllaznia” për të vijuar financimin e ushtrimit të sporteve në disiplinat sportive sipas metodologjisë LOD. Me VKB nr 18 datë 25.03.2021 “Për vazhdimin e financimit të disiplinave sportive sipas PBA 2021-2023, programi “Sport dhe Argëtim”, përmes metodologjisë LOD, pas mbylljes së funksionimit të Klubit Sportiv “Vllaznia”, pika 1, me datë 30.06.2021 është miratuar mbyllja e institucionit të varësisë Klubi Sportiv “Vllaznia”.

Sipas pikës 2 të VKB nr. 69, datë 30.10.2017, Këshilli Bashkiak Shkodër ka miratuar Metodologjinë LOD, për financime organizatave të shoqërisë civile. Kjo Metodologji LOD, bën të mundur një alokim transparent të fondeve për ofrimin e shërbimeve përmes Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) dhe siguron forcimin e besimit të ndërsjellë duke maksimizuar në të njëjtën kohë, përdorimin e fondeve të caktuara për to dhe duke plotësuar nevojat e komuniteteve vendore. Duke e konsideruar praktikën e metodologjisë LOD si një praktikë e mirë unifikuese, mbështetur në standartet e Bashkimit Evropian për menaxhimin e projekteve, Bashkia Shkodër është angazhuar që të financojë fonde publike duke angazhuar shoqatat sportive, pjesë e shoqërisë civile, për të realizuar aktivitetet sportive dhe mbështetur të rinjtë që ushtrojnë sportet. Qëllimi përfundimtar është zbatimi i financimit të sportit në bazë projekti, në mënyrë që të realizojmë objektivat tona për zhvillimin e sportit, në bashkëpunim

dhe duke mbështetur shoqatat sportive. Aktualisht Bashkia Shkodër do vazhdojë të financojë përhapjen dhe masivizimin e sportit nëpërmjet dhe në abshkëpunim me shoqatat sportive, të cilat Bashkia Shkodër do vazhdojë t'i mbështesë si me fonde ashtu dhe me vënien në dispozicion të infrastrukturë sportive përkatëse në pronësi të saj për trajnim dhe aktivitete sportive.

Në vitin 2021 ka përfunduar procedura e privatizimit të Klubit të Futbollit “Vllaznia”sh.a, ku Bashkia Shkodër ishte aksionere e vetme me 100% të aksioneve. Me datë 30.08.2021 Bashkia Shkodër ka njoftuar fituesin e ankandit me objekt: “Shitje e aksioneve të KF Vllaznia sh.a në masën 100%”. Ai është bashkimi i operatorëve Alba Sport and Entertainment shpk and Albafoto shpk me përfaqësues të bashkimit të kandidatëve blerës, z. Alban Xhaferi.

Tabela 1. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike

PBA 2022-2024								
Raport	Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike							
Bashkia Shkoder	Institucioni-							
Programi	8130	Sport dhe Argëtim						
Shpenzimet e Programit (000 ALL)								
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2019	2020	2021	2021	2022	2023	2024
		Fakt	Fakt	Buxh. Fillest.	Buxh. Pritshëm	Plani	Plani	Plani
Paga dhe Sigurime								
Paga	600	10,024	15,657	25,530	12,288	17,233	17,576	17,928
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	601	1,726	3,197	5,405	3,059	2,741	2,796	2,852
Korente								
Mallra dhe Shërbime	602	36,529	40,462	50,807	35,973	23,360	18,065	40,663
Subvencion	603	0	0	0	0	0	0	0
Transferta të Brendshme	604	63,909	44,000	45,891	102,782	41,428	41,428	41,428
Transferta të Jashtme	605	0	0	0	0	0	0	0
Transferta për Familje & Individë	606	58	0	0	1,327	18	18	18
Shpenzime Kapitale								
Aktive të Paprekshme	230	0	0	0	0	0	0	0
Aktive të Prekshme	231	29,747	4,627	101	0	0	0	0
TOTALI		141,993	107,943	127,734	155,429	84,780	79,883	102,889

Komente

Programi 08130: Sport dhe argëtim ka si burim financimi kryesisht tranfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat e tjera si dhe të ardhurat që mbidhen nga vetë institucionet sportive që për vitet 2022-2024 janë planifikuar zero. Ndërsa shpenzimet neto janë shpenzime që mbulohen nga të ardhurat e bashkisë dhe transfertat e pakushtëzuar me një mesatare për vitet 2019-2024 prej 97.5 %. Pjesën më të madhe të shpenzimeve e zënë shpenzimet korrente me rreth 76.4 % në vitin 2022, 74.5 % në vitin 2023 dhe 79.8 % në vitin 2024. Ndërsa shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore zënë 23.6 % në vitin 2022, 25.5 % në vitin 2023 dhe 20.2 % në vitin 2024.

2. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Tabela 2 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

POLITIKA E PROGRAMIT					
Programi Buxhetor Afatmesëm		2022- 2024			
Programi	08130	Sport dhe argëtim			
Përshkrimi i Programit					
<ul style="list-style-type: none">•Vënie në funksionim ose mbështetje e strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive (fusha lojërash, fusha tenisi, pishina noti, korsi vrapim, ringje boksi, pista patinazhi, palestra etj.)•Mbështetje për ekipet përfaqësuese vendore në veprimtaritë sportive;•Mbështetje e strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive (struktura për qëndrimin e spektatorëve; sidomos vende të pajisura për lojëra me letra, lojëra me tabelë etj.);• Grante, hua ose financime për të mbështetur ekipe apo lojtarë individuale.• Vënie në funksionim ose mbështetje për ambjente që përdoren për veprimtari çlodhëse (parqe, plazhe, kampingje dhe vendqëndrimet përkatëse) të ofruara në bazë jotregtare;					
1	Qëllimi i Politikës së Programit	Krijimi i infrastrukturës mbështetëse dhe bazës materiale për zhvillimin e proceseve stërvitore për të gjitha ekipet zinxhir të klubit shumësportësh “Vllaznia”. Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete sportive dhe zhvillimin e sportit në komunitet synojmë organizimin e përvitshëm të programit “Jeto me sportin”.			
	Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi	2021	2022	2023	2024
		Buxheti	Plani	Plani	Plani
	Struktura profesionale për veprimtari sportive.	3	3	3	3

	Mbështetje e Klubit të Futbollit Vllaznia, në 000*lekë	45,000	0	0	0
	Numri i ekipeve	24	24	24	24
	Të ardhurat nga aktivitetet sportive (në mijë lekë)	1450	0	0	0
	Numri i disiplinave sportive	14	14	14	14
	Numër pjesëmarrësish në aktivitete sportive	500	700	700	700
1.1.	Objektivi i Politikës së Programit	Të promovojmë dhe të nxisim pjesëmarrjen aktive të të rinjve në aktivitete sportive dhe sociale, si aktorë thelbësorë në zhvillimin e territorit.			
	Treguesit e Performancës për Objektivin				
	Pjesëmarrës në aktivitetet sportive - ndryshimi në % kundrejt vitit paraardhës.	-29%	40%	0%	0%
1.2.	Objektivi i Politikës së Programit	Menaxhimi dhe mirëadministrimi i strukturave sportive dhe krijimi infrastrukturës së përshtatshme dhe cilësore për të gjithë sportet.			
	Treguesit e Performancës për Objektivin				
	Efiçenca e mbështetjes buxhetore për terrenet sportive - ndryshimi në % kundrejt vitit paraardhës.	-7%	246%	-12%	63%
	Mbështetje e Klubit të Futbollit Vllaznia- ndryshimi në % kundrejt vitit paraardhës.	2%	-100%	0%	0%
1.3.	Objektivi i Politikës së Programit	Garantimi i pjesëmarrjes së të gjithë ekipeve të Klubit Vllaznia në Kampionatet Kombëtare me synim arritjen e rezultateve cilësore .			
	Treguesit e Performancës për Objektivin				
	Mbështetja për ekipet përfaqësuese të Bashkisë në veprimtaritë sportive në kampionate kombëtare dhe ndërkombëtare (numri i të rinjve që merren me sport në vite)	454	454	454	454
	Mbështetja për ekipet përfaqësuese të Bashkisë në veprimtaritë sportive në kampionate kombëtarë dhe ndërkombëtare.- Ndryshimi i numrit të të rinjve që merren me sport ndër vite (%)	0%	0%	0%	0%
1.4.	Objektivi i Politikës së Programit	Kujtesë e historikut sportiv shkodran dhe promovim i sportit.			

Treguesit e Performancës për Objektivin				
Numër Qendër olimpike		1	1	1
Numër Muze sporti	1	1	1	1

Kryetari i NJVV		Kordinatori i GMS		Drejtuesi i Programit	
Emri Mbiemri:		Emri Mbiemri:		Emri Mbiemri:	
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Datë:		Datë:		Datë:	

3. Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Tabela 3 Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit

SHPENZIMET E PRODUKTEVE TË PROGRAMIT					
Programi Buxhetor Afatmesëm			2022- 2024		
Programi		8130	Sport dhe argëtim		
1.1.	Objektivi i Politikës së Programit	Të promovojmë dhe të nxisim pjesëmarrjen aktive të të rinjve në aktivitete sportive dhe sociale, si aktorë thelbësorë në zhvillimin e territorit.			
1.1.A.	Produkti	Pjesëmarrje aktive e rinisë në aktivitetet argëtuese dhe sportive			
	<i>Kodi i Projektit</i>	P08130.O1.A1 - P08130.O1.A5			
	Përshkrimi i Produktit:	Argëtimi dhe pjesëmarrje në aktivitete rinore sportive			
	Njësia Matëse	numër të rinj, pjesëmarrës në aktivitete rinore gjatë vitit.			
		2021	2022	2023	2024
		Buxheti	Plani	Plani	Plani
	Sasia	500	700	700	700
	Kosto totale (në mijë lekë)	2,424	1,708	1,708	1,708
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	4.8	2.4	2.4	2.4
	Ndryshimi në % i Sasisë		40.0%	0.0%	0.0%
	Ndryshimi në % i koston totale		-29.5%	0.0%	0.0%
	Ndryshimi në % i koston për njësi		-49.7%	0.0%	0.0%
1.2.	Objektivi i Politikës së Programit	Menaxhimi dhe mirëadministrimi i strukturave sportive dhe krijimi			

		infrastrukturës së përshtatshme dhe cilësore për të gjithë sportet.			
1.2.A. Produkti		Struktura sportive të mirëmbajtura dhe të mirëmenaxhuara			
	Kodi i Projektit	P08130.O2.A1 - P08130.O2.A2			
	Përshkrimi i Produktit:	Mirëmbajtja e tre strukturave sportive të rëndësishme pallatit të sportit Qazim Dervishi, Stadiumi Loro Borici dhe kompleksit sportiv Reshit Rusi.			
	Njësia Matëse	numër strukturash në funksion të sportit			
		2021	2022	2023	2024
		Buxheti	Plani	Plani	Plani
	Sasia	3	3	3	3
	Kosto totale (në mijë lekë)	80,325	41,528	36,631	59,637
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	26,775.0	13,842.7	12,210.3	19,879.0
	Ndryshimi në % i Sasisë		0.0%	0.0%	0.0%
	Ndryshimi në % i kostos totale		-48.3%	-11.8%	62.8%
	Ndryshimi në % i kostos për njësi		-48.3%	-11.8%	62.8%
1.3. Objektivi i Politikës së Programit		Garantimi i pjesëmarrjes së ekipeve të të rinjve që merren me sport në 14 disiplina të ndryshme, në kampionatet kombëtare me synim arritjen e rezultateve cilësore .			
1.3.A. Produkti		Mbështetje të të rinjve që merren me sport në ekipet e disiplinave sportive të mbështetura nga Bashkia Shkodër			
	Kodi i Projektit	P08130.O3.A1 - P08130.O3.A25			
	Përshkrimi i Produktit:	Mbështetje dhe nxitje për rritjen e numrit të të rinjve që merren me sport në ekipet sportive.			
	Njësia Matëse	numri i të rinjve që merren me sport			
		2021	2022	2023	2024
		Buxheti	Plani	Plani	Plani
	Sasia	454	454	454	454
	Kosto totale (në mijë lekë)	22,837	41,544	41,544	41,544
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	50.3	91.5	91.5	91.5
	Ndryshimi në % i Sasisë		0.0%	0.0%	0.0%
	Ndryshimi në % i kostos totale		81.9%	0.0%	0.0%
	Ndryshimi në % i kostos për njësi		81.9%	0.0%	0.0%
1.4. Objektivi i Politikës së Programit		Kujtesë e historikut sportiv shkodran dhe promovim i sportit.			
1.4.A. Produkti		Ngritja e një qendre olimpike dhe muzeut të sportit			
	Kodi i Projektit	P08130.O4.A1 - P08130.O4.A2			

Përshkrimi i Produktit:	Mbështetje për ngritjen e një qendre olimpike dhe muzeut të sportit.			
Njësia Matëse	Numri i qendrave olimpike dhe muzeve të ngritura			
	2021	2022	2023	2024
	Buxheti	Plani	Plani	Plani
Sasia	1	2	2	2
Kosto totale (në mijë lekë)	0	0	0	0
Kosto për njësi (në mijë lekë)	0.0	0.0	0.0	0.0
Ndryshimi në % i Sasisë		100.0%	0.0%	0.0%
Ndryshimi në % i kostos totale		#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!
Ndryshimi në % i kostos për njësi		#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!

Kryetari i NJVV		Kordinatori i GMS		Drejtuesi i Programit	
Emri Mbiemri:		Emri Mbiemri:		Emri Mbiemri:	
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Datë:		Datë:		Datë:	



4. Projektet e Investimeve të Programit

Tabela 4 Projektet e Investimeve të Programit

						PBA	2022	-2024			
						(000 ALL)					
Projektet e Investimeve											
Bashkia Shkoder		Institucioni -									
Programi		8130	Sport dhe Argëtim								
Kodi Projektit	Emri i Projektit	Kosto Totale e Projektit	Burimi i Financimit	Data Fillimit	Data Përfund.	2019	2020	2021	2022	2023	2024
						Fakti	Fakti	Buxheti	Plani	Plani	Plani
1410482	Ndërtim fusha sportive	12,031	Fondet e veta	2018	2019	12,005					
1410506	Projekti "Jeto me Sportin" Rikualifikim i terreneve sportive në shkollat Oso Kuka, B. Shkodër, Ana e Malit Oblikë dhe "At Gjon Kama" Gur i Zi	1,500	Fondet e veta	2019	2019	1,500					
M112790	Projekti "Jeto me Sportin" Rikualifikim i terreneve sportive në shkollat Oso Kuka, B. Shkodër, Ana e Malit Oblikë dhe "At Gjon Kama" Gur i Zi (FZHR)	17,941	FZHR	2018	2019	14,712	3,229				

1410201	Blerje pajisje TIK		Fondet e veta			150	93				
1410317	Blerje orendi dhe pajisje zyre		Fondet e veta				100				
1410359	Blerje instalime teknike, pajisje sportive (tabela basketbolli, shtylla, rrjete volejboli)		Fondet e veta			192	100				
1410412	Rikonstruksion banjo publike		Fondet e veta			828					
1410422	Rikonstruksion i pjesshëm i Pallatit të Sportit		Fondet e veta			360					
1410619	Blerje prozhektorë për ndriçimin e fushës së stërvitjes së Pallatit të Sportit "Qazim Dervishi"		Fondet e veta				94				
1410620	Blerje pajisje pastrimi-fshesë me korent profesionale		Fondet e veta				70				
1410800	Rikonstruksion terren sportiv (salla e ndeshjeve lojëra me dorë 700 m2)		Fondet e veta				942				
	Totali	31,471				29,747	4,628	0	0	0	0

5. Të Dhëna mbi Programin

Tabela 5 Të dhënat e Programit

Të Dhëna Bazë mbi Programin						
	Të Përgjithshme	2020	2021	2022	2023	2024
Të dhënat e programit/ Vitet						
Numër pjesëmarrësish në aktivitete sportive		700	500	700	700	700
Numri i publikimeve sportive		0	2	3	4	4
Struktura për veprimtari sportive		3	3	3	3	3
Administrimi dhe Mirëmbajtje e objekteve/ terreneve sportive në pronësi të Bashkisë Shkodër në 000/lekë		12,879	12,000	41,528	36,631	59,637
Mbështetje e Klubit të Futbollit “Vllaznia”, në mijë lekë		44,000	45,000	0	0	0
Numri i stafit Sport Klub “Vllaznia”:		58	58			
<i>Kohë të plotë</i>		21	21			
<i>Kohë të pjesëshme</i>		37	37			
Numri i ekipeve		24	24	24	24	24
Numri i të rinjve që merren me sport		454	454	454	454	454
Numri i disiplinave sportive të mbështetura		14	14	14	14	14

Buxheti për mbështetjen e ekipeve sportive në mijë lekë	21,837	22,837	41,544	41,544	41,544
Shpenzime Klubit Shumësportësh "Vllaznia" në mijë lekë	44,338	47,162	0	0	0
Të ardhurat nga aktivitetet sportive (në mijë lekë)	152	1,450	0	0	0
<i>Qendër olimpike</i>	0	0	0	1	1
<i>Muze sporti</i>	0	0	1	1	1
Të ardhura nga Stadiumi "Loro Borici"	4,034	800	0	0	0
Numri i punonjësve - Njësia Mirëmbajtje terrene sportive në pronësi të Bashkisë			31	31	31

6. Projektet e planifikuara për PBA 2022-2024

Tabela 6 Emërtimet e aktiviteve

Projekte të planifikuara			000/lekë
Kodi i projektit/Emërtimi i Aktivitetit	Buxheti 2022	Buxheti 2023	Buxheti 2024
P08130.O1.A1 Maratona e pavarësisë Ulqin-Shkodër	455	455	455
P08130.O1.A2 Beach voley	534	534	534
P08130.O1.A3 "Memorial Vllaznia" në boks.	400	400	400
P08130.O1.A4 Festivali i Shahut "Çesk Jubani"	119	119	119
P08130.O1.A5 Shkodra Tennis Tournament	200	200	200
P08130.O2.A1 Administrimi dhe Mirëmbajtje e objekteve/ terreneve sportive në pronësi të Bashkisë Shkodër	41,528	36,631	59,637
P08130.O2.A2 Administrimi i Klubit të futbollit Vllaznia	-	-	-
P08130.O3.A1 Ekipi i basketbollit i të rriturve për meshkuj	3,133	3,133	3,133
P08130.O3.A2 Mbështetje e ekipit të basketbollit meshkuj të rinj	806	806	806
P08130.O3.A3 Mbështetje e ekipit të basketbollit femra të rritura	2,548	2,548	2,548
P08130.O3.A4 Mbështetje e ekipit të basketbollit femra të reja	573	573	573
P08130.O3.A5 Mbështetje e ekipit të volejbollit meshkuj të rritur.	4,033	4,033	4,033
P08130.O3.A6 Mbështetje e ekipit të volejbollit femra të rritura	2,716	2,716	2,716
P08130.O3.A7 Mbështetje e ekipit të Volejboll meshkuj të rinj	724	724	724
P08130.O3.A8 Mbështetje e ekipit të Volejbollit femra të reja	706	706	706
P08130.O3.A9 Mbështetje e ekipit të boksit meshkuj të rritur	3,045	3,045	3,045
P08130.O3.A10 Mbështetje e ekipit të atletikës meshkuj të rritur	3,402	3,402	3,402
P08130.O3.A11 Mbështetje e ekipit Çiklizëm meshkuj të rritur	1,598	1,598	1,598
P08130.O3.A12 Mbështetje e ekipit të Gjymnastikës femra të rritura	654	654	654
P08130.O3.A13 Mbështetje e ekipit të Hendbollit meshkuj të rritur dhe të rinj	342	342	342
P08130.O3.A14 Mbështetje e ekipit të Mundjes meshkuj të rritur	647	647	647

P08130.O3.A15 Mbështetje e ekipit të Notit të rritur dhe të rritura	365	365	365
P08130.O3.A16 Mbështetje e ekipit të peshëngritjes meshkuj të rritur	713	713	713
P08130.O3.A17 Mbështetje e ekipit të Ping-Pong të rritur.	335	335	335
P08130.O3.A18 Mbështetje e ekipit të Shahut të rritur.	645	645	645
P08130.O3.A19 Mbështetje e ekipit të xhudos për moshat të rritur/ të rritura.	1,216	1,216	1,216
P08130.O3.A20 Mbështetje e ekipit të boksit femra.	865	865	865
P08130.O3.A21 Mbështetje e ekipit të xhudos për moshat të rinj / të reja	612	612	612
P08130.O3.A22 Mbështetje e ekipit të atletikës femra	150	150	150
P08130.O3.A23 Mbështetje e ekipit të Futbollit femra të rritura	1,000	1,000	1,000
P08130.O3.A24 . Mbështetje e futbollit për të rinjtë	10,000	10,000	10,000
P08130.O3.A25 Shpërblim për rezultatet në arenën ndërkombëtare për sportistët e trajnerët që përfaqësojnë ekipet e Shkodrës	716	716	716
P08130.O4.A1.Studim për ngritjen e një kompleksi Olimpik	-	-	-
Totali	84,780	79,883	102,889

Nr. 1	P08130.O1.A1. Maratona e pavarësisë Ulqin- Shkodër	Funksioni 8: Argëtim, kultura dhe feja N/Funksioni 081: Shërbime rekreative dhe sportive Llojet e programit 08130: Sport dhe argëtim
-------	-------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit : Maratonë vrapimi 42 km Ulqin - Shkodër

i. Situata

Maratona e Pavarësisë Ulqin- Shkodër zhvillohet që nga viti 2012 me datën 28 Nëntor si një mënyrë sportive për të bashkuar dy vende fqinje me tradita të ngjashme. Kjo Maratonë ndryshon çdo vit nisjen e saj, një vit niset nga Ulqini dhe një vit nga Shkodra. Këtë vit Maratona niset nga Shkodra për të mbërritur në Ulqin. Vit pas viti iu bashkuan Maratonës edhe fëmijë, por edhe të rinj të cilët e shoqërojnë maratonën edhe me biçikleta.

Maratona e Pavarësisë është një rast i suksesshëm i bashkëpunimit dhe i gjithë- përfshirjes. Nga viti në vit pjesëmarrësit janë nga vende të largëta jo vetëm nga Ballkani por edhe më larg.

Gjatë shtatë viteve të fundit në këtë aktivitet kanë marrë pjesë rreth 150 atletë dhe amatorë, rreth 500 meshkuj e 200 femra pjesëmarrës nga Shqipëria, Kosova, Rusia, Serbia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut etj.

Ky aktivitet vazhdon të promovojë marrëdhëniet e ndërsjellta dhe fqinjësinë e mirë duke bashkuar sportin, turizmin dhe kulturën mes dy vendeve.

Për vitin 2021 Bashkia Shkodër ishte pikënisja e kësaj maratone e cila përfundoi në Komunën e Ulqinit. Në vitin 2022 do të duhet që në bashkëpunim me organizatorët e Maratonës të vendosim se si do të jetë drejtimi i nisjes dhe mbërritjes si dhe teknikalitetet dhe detajet e garës.



ii. Synimi i projektit

- Përkujtimin e ngjarjes historike më të madhe për kombin shqiptar, Ditën e Pavarësisë 28 Nëntor 1912.
- Promovimin e aktiviteteve sportive për të rinjtë.
- Rritjen e bashkëpunimit të atletëve dhe të rinjve të vendeve fqinje.
- Bashkëpunimin e njësisve vendore të Shkodrës dhe të Ulqinit.
- Promovimi i zgjerimit të gjeografisë së pjesëmarrësve me synim ndërkombëtarizimin e kësaj veprimtarie.
- Përfshirjen e kësaj veprimtarie sportive në axhendën e veprimtarive sportive kombëtare.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

- Ngritja e grupit organizator me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Bashkisë së Shkodrës dhe të Komunës së Ulqinit.
- Planifikimi dhe organizimi i aktiviteteve promovuese dhe mediatike për aktivitetin.
- Regjistrimi i pjesëmarrësve.
- Organizimi i aktivitetit, logjistika dhe menaxhimi i eventit sportiv.

b) Rezultatet që prisni

- Gara e Maratonës pjesë e rëndësishme e aktiviteteve të javës së Pavarësisë 2022.
- Numri dhe gjeografia e pjesëmarrësve të atletëve në këtë aktivitet, nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, nga rajoni dhe Europa rritet.
- Promovimi i fqinjësisë së mirë dhe marrëdhënieve ndërmjet vendeve tona përmes aktiviteteve sportive e kulturore.

c) Aktorët e mundshëm

Komuna e Ulqinit
Të rinjtë
Sportistë
Qytetarë sportdashës
Dashamirë të atletikës

d) Kontributet e mundshme në projekt

Bashkia Shkodër
Komuna e Ulqinit
Federata Shqiptare e Atletikës

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2022	Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operativ e	Transferime	Kapital e
A.1 Materiale publicitare	24			24		


A.2	Transport	15			15		
A.3	Çmime për fituesit Çmimi i parë për dy kategori 2 * 70,000 lekë Çmimi i dytë për dy kategori 2 * 50,000 Çmimi i tretë për dy kategori 2 * 40,000	320			320		
A.4	Honorare për kampionatin e pavarësisë 8 persona x 12,000	96			96		
	Shuma	455			455		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferime	Kapital e
A.1	Maratona e pavarësisë Ulqin- Shkodër	455			455		
	Shuma	455			455		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferime	Kapital e
A.1	Maratona e pavarësisë Ulqin- Shkodër	455			455		
	Shuma	455			455		
f) Periudha e zbatimit 2022 2023 2024		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr. 2	P08130.O1.A2.	Funksioni 8: Argëtim, kultura dhe feja
	Beach volley	N/Funksioni 081: Shërbime rekreative dhe sportive
		Llojet e programit 08130: Sport dhe argëtim

a)Përshkrimi i shkurtër i projektit : Turne volejboli 3- ditor masiv dhe profesionist në Nj.A Velipojë

i. Situata

Velipoja është një nga plazhet më të frekuentuara në veriun e Shqipërisë dhe gjatë muajve të verës numri i frekuentuesve është më shumë se 100,000 pushues. Shumë të rinj ushtrojnë sporte të ndryshme që mundësohen gjatë stinës së verës, në plazh. Volejboli është një nga sportet më të preferuara të stinës së verës në Velipojë.



Në këto rrethana të reja nga ana e Bashkisë së Shkodrës për të katërtin vit radhazi vlerësohet e rëndësishme nxitja e mbështetja e të rinjve që dëshirojnë të praktikojnë sport në plazh por edhe profesionistëve, veçanërisht volejbollin në plazh.

Ndër vite Beach Volley për profesionistë mbledhi sportistë nga qytetet e ndryshme të Shqipërisë, dhe jo vetëm, duke krijuar një atmosferë, konkurrim dhe pjesëmarrësve të pushuesve që e ndjekin me shumë kënaqësi.

Ky aktivitet, është pjesë e aktiviteteve që Bashkia e Shkodrës organizon në Velipojë për promovimin e sportit, dhe nxitjen e turizmit të plazhit.

ii. Synimi i projektit

- Synojmë gjallërimin e jetës sportive në plazhin e Velipojës.
- Synojmë promovimin e sportit si instrument edukues.
- Synojmë të mbështesim profesionistët kombëtarë të volejbollit.
- Synojmë të promovojmë plazhin e Velipojës.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

- Ngritja e grupit të punës me pjesëmarrjen e të rinjve të cilët duan të angazhohen në organizim.
- Programimi i aktiviteteve dhe axhendës së zhvillimit të aktivitetit.
- Përzgjedhja e vendeve ku do të krijohet fusha e "beach voley"
- Përgatitja dhe ndërtimi i fushës.
- Sigurimi i mjeteve të nevojshme si: rrjeta, mbajtëse të rrjetës, rrethimi i fushës, topat e volejbollit etj.
- Sigurimi dhe pagesa për arbitrat dhe përgatitja e çmimeve për fituesit.
- Sigurimi i vendqëndrimit për pjesëmarrësit.
- Organizim, monitorim dhe raportim i aktivitetit.
- Likujdim financiar i shërbimeve të financuara.

b) Rezultatet që prisni

- Pjesëmarrje aktive e të rinjve në ndeshjet e beach volley.
- Argëtim dhe zbavitje për pushuesit.
- Promovim i sportit si instrument edukues dhe burim shëndeti.
- Mbështetje të profesionistëve në rang kombëtar.
- Promovimi i turizmit në plazhin e Velipojës.

c) Aktorët e mundshëm

Bashkia Shkodër
Njësia Administrative Velipojë
Mbështetës të aktivitetit

d) Kontributet e mundshme në projekt

Bashkia Shkodër
Federata shqiptare e Volejbollit
Donatorë të mundshëm

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Pagesa për arbitra 1 kryearbitër x 18,000 lekë 10 arbitra x 12,000 lekë	138			138		
A.2	Materiale publicitare	56			56		
A.3	Çmimet për fituesit: Vendi i parë 4 persona x 20,000 lekë Vendi i dytë 4 persona x 12,000 lekë Vendi i tretë 4 persona x 8,000 lekë	160			160		
A.4	Akomodim, trajtim ushqimor	180			180		
Shuma		534			534		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Beach volley	534			534		

	Shuma	534			534		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Beach volley	534			534		
	Shuma	534			534		
f) Periudha e zbatimit 2022 2023 2024		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr. 3	P08130.O1.A3. Memorial "Vllaznia", boks	Funksioni 8: Argëtim, kultura dhe feja N/Funksioni 081: Shërbime rekreative dhe sportive Llojet e programit 08130: Sport dhe argëtim				
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit: Turne ndërkombëtar në boks						
i. Situata						
<p>Ekipi i boksit i të rriturve, SK "Vllaznia", që në vitin 2002, merr pjesë në aktivite ndërkombëtare në bashkëpunim me federatën shqiptare të boksit sipas rregullores së Federatës Ndërkombëtare Europiane në boks in amator.</p> <p>Ekipi i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë të ekipit kombëtar dhe 5 trajnerë. Ekipi i boksit të të rriturve ka marrë pjesë në këtë eveniment për 14 vite rresht duke dalë kampion në këtë aktivitet dhe duke marrë medalje ari, argjendi dhe bronzi, gjithsej 48 medalje.</p> <p>Në këto aktivite prej 15 vitesh kanë marrë pjesë edhe shumë ekipe nga Kazakistani, Gjermania, Italia, Bullgaria, Hungaria, Maqedonia e Veriut, Kosova, Mali i Zi, Kanadaja, Australia, Kroacia, Armenia, Irlanda etj. Në prill të vitit 2019 morën pjesë ekipe nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Kroaci, Bullgaria. Bashkia Shkodër mbështet aktivitetin për promovimin e sportit.</p> <p>Vitin e kaluar ky aktivitet nuk u zhvillua si pasojë e pandemisë globale.</p>						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Organizimi i suksesshëm i aktivitetit ndërkombëtar "Memorial Vllaznia 2022". Promovimi i sportit të boksit, i sportistëve të dalluar në qytetin e Shkodrës dhe në arenën ndërkombëtare 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Planifikim i organizimit të aktivitetit në bashkëpunim me trajnerët dhe organizatat e sportit të boksit. Sigurim i mjeteve dhe aktiviteteve logjistike për mbarëvajtjen e aktivitetit. Ofrimi i bazës materiale që nevojitet për zhvillimin normal të këtij aktiviteti. Organizim, monitorim dhe raportim i aktivitetit. Likuidim financiar i shërbimeve të financuara. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> Ekipi synon të zërë vendin e parë, duke marrë medalje ari, argjendi e bronzi. 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Shoqatat sportive Sponsorë Sportdashësit Bashkia Shkodër.				Bashkia Shkodër Federata Shqiptare e Boksit Donatorët e mundshëm		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
A.1	Akomodim dhe trajtim ushqimor	400	Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
Shuma		400			400	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
A.1	Organizim i aktivitetit	400	Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
Shuma		400			400	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
A.1	Organizim i aktivitetit	400	Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
Shuma		400			400	
f) Periudha e zbatimit 2022 2023 2024			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër			

Nr. 4	P08130.O1.A4. Festivali i Shahut "Çesk Jubani"	Funksioni 8: Argëtim, kultura dhe feja N/Funksioni 081: Shërbime rekreative dhe sportive Llojet e programit 08130: Sport dhe argëtim
-------	---------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit : Turne shahu për gjimnazet dhe veteranët

i. Situata

Loja e shahut ka një traditë pozitive dhe të hershme në qytetin e Shkodrës. Tradicionalisht pranë klubit Vllaznia ka funksionuar ekipi i shahut për meshkuj dhe femra, të cilët kanë arritur rezultate sportive shumë të mira në vite, duke u shpallur, disa prej tyre edhe Kampion Kombëtar. Sporti i shahut është një nga sportet që ndihmon në zhvillimin pozitiv të aftësive njohëse të fëmijëve dhe nxënësve. Njëkohësisht ndikon në krijimin e besimit në vetvete, rritjen e kujtesës e të menduarit, rritjen e përqëndrimit dhe të përmirësimit të rezultateve në mësimet tek fëmijët dhe të rinjtë. Bashkia Shkodër, në vitin 2021 mbështeti aktivitetin disa ditor të zhvilluar në Qendrën Kulturore të Fëmijëve, si dhe organizoi projektin "Festivali i Shahut" në Shkurt në Qendrën Rinore "Atelie" ku morën pjesë moshë të reja dhe dolën fitues për çdo kategori. Për shkak të pandemisë globale ky aktivitet nuk u bë i mundur të përmbylej në fazën e tij të fundit: përzgjedhja e kampionit të qytetit. Në vitin 2022 synojmë të organizojmë këtë aktivitet duke kaluar disa faza, me fëmijët e QKF, me përfshirjen e gjimnazistëve si dhe të veteranëve; duke krijuar kështu larmi dhe përfshirje të gjerë.



ii. Synimi i projektit

- Synojmë edukimin e të rinjve për përfshirje më të gjerë në aktivitete rinore, vullnetare, sportive.
- Synojmë promovimin e vullnetarizmit si mundësi për të fituar aftësi të reja si dhe për të përmirësuar kushtet e mjedisit.
- Synojmë gjallërimin e jetës sociale të të rinjve.
- Afrimin e të rinjve me njëri-tjetrin.
- Promovimi i sportit si veprimtari sociale, integruese dhe burim shëndetit.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

- Planifikimi i zbatimit të aktivitetit në bashkëpunim me QKF.
- Koordinimi i aktorëve që marrin pjesë në aktivitetin specifik.
- Sigurimi i mjeteve dhe aktiviteteve logjistike për mbarëvajtjen e aktivitetit.
- Ofrimi i bazës materiale që nevojitet për zhvillimin normal të këtij aktiviteti.
- Organizim, monitorim dhe raportim i aktivitetit.
- Likuidim financiar i shërbimeve të financuara.

b) Rezultatet që prisni

- Gjithëpërfshirja e moshave të reja në aktivitete rinore të Bashkisë Shkodër.
- Pjesëmarrje aktive e të rinjve në aktivitete, afrimi i të rinjve me sportin.
- Argëtim dhe zbatim për të rinjtë dhe qytetarët.
- Promovim i sportit si instrument edukues dhe burim shëndeti.

<ul style="list-style-type: none"> Mbështetje e profesionistëve në rang kombëtar. Përmirësimi i situatës mjedisore, sociale, rinore, kulturore si pasojë e zhvillimit të aktiviteteve vullnetare gjatë vitit. 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Bashkia Shkodër Qendra Rinore Atelie Qendra Kulturore e Fëmijëve				Bashkia Shkodër Federata shqiptare e Shahut Donatorë të mundshëm		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Honorare Kryegjyqtari 1x27,000 lekë Gjyqtarë: 2x12,000 lekë Kampioni i qytetit: 1x 20,000 lekë Fitues 2 kategori (M&F) 4 x12,000 lekë	119			119	
Shuma		119			119	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Festivali i Shahut "Çesk Jubani"	119			119	
Shuma		119			119	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Festivali i Shahut "Çesk Jubani"	119			119	
Shuma		119			119	
f) Periudha e zbatimit 2022 2023 2024		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr. 5	P08130.O1.A5. Shkodra Tennis Tournament	Funksioni 8: Argëtim, kultura dhe feja N/Funksioni 081: Shërbime rekreative dhe sportive Llojet e programit 08130: Sport dhe argëtim				
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit :						
i. Situata						
<p>Në qytetin e Shkodrës, sporti i tenisit ka marrë zhvillim duke numëruar kështu qindra fëmijë, të rinj dhe të rritur të cilët e ushtrojnë këtë sport. Bashkia Shkodër ka si qëllim të mbështesë të rinjtë drejt jetesës së shëndetshme dhe sportit si instrument edukues dhe burim shëndeti.</p> <p>Shkodra Tennis Tournament është organizuar gjatë viteve të fundit nga organizata sportive të angazhuar në këtë shërbim. Në vitin 2022 Bashkia Shkodër synon të bëhet pjesë mbështetëse e këtij turneu duke financuar për personelin ndihmës, arbitra, materiale dhe për dukshmërinë. Synojmë që çdo vit ky turne të fuqizohet duke tërhequr sa më shumë të rinjtë, për ta kthyer atë në një event të rëndësishëm.</p>						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Synojmë gjallërimin e jetës sportive tek fëmijët dhe të rinjtë • Synojmë promovimin e sportit si instrument edukues. • Promovimi i sportit si veprimtari sociale, integruese dhe burim shëndetit. • Synojmë të mbështesim profesionistët dhe amatorët e tenisit 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Detajim i mbështetjes së aktivitetit sipas kërkesës së organizatës së tenisit në Shkodër. Kjo mbështetje mund të jetë: <ul style="list-style-type: none"> ○ Sigurim i mjeteve dhe aktiviteteve logjistike për mbarëvajtjen e aktivitetit. ○ Ofrimi i bazës materiale që nevojitet për zhvillimin normal të këtij aktiviteti. ▪ Organizim, monitorim dhe raportim i aktivitetit. ▪ Likuidim financiar i shërbimeve të financuara. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> • Argëtim dhe zbatimje për të rinjtë • Promovim i sportit si instrument edukues dhe burim shëndeti. • Mbështetje të profesionistëve dhe amatorëve në nivel kombëtar. 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Bashkia Shkodër Mbështetës të aktivitetit				Bashkia Shkodër Federata shqiptare e Tenisit Donatorë të mundshëm		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	Pagesa për arbitra 12 arbitra x 12,000 lekë	144			144	
A.2	Materiale publicitare	56			56	
Shuma		200			200	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	Shkodra Tennis Tournament	200			200	
Shuma		200			200	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	Shkodra Tennis Tournament	200			200	
Shuma		200			200	
f) Periudha e zbatimit 2022 2023 2024			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			
			Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër			

Nr.6	P08130.O2.A1. Administrimi dhe mirëmbajtje e objekteve/ terreneve sportive në pronësi të Bashkisë Shkodër	Funksioni 8:Argëtim, kultura dhe feja N/Funksioni 081: Shërbime rekreative dhe sportive Llojet e programit 08130: Sport dhe argëtim
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit: Mirëmbajtje e objekteve, terreneve, fushave sportive të Bashkisë Shkodër.		
i. Situata		
<p>Pallati i sportit "Qazim Dervishi" pronë e Bashkisë Shkodër është përdorur dhe mirëmbajtur nga Sport Klub Vllaznia deri në muajin Qershor 2021. Përmes VKB nr. 18 dt. 25.03.2021 "Për vazhdimin e financimit të disiplinave sportive sipas PBA 2021-2023, programi sport dhe argëtim, përmes metodologjinë LOD, pas mbylljes së funksionimit të Sport Klub Vllaznia" ky institucion është mbyllur dhe administrimi i këtij impianti bëhet nga Bashkia Shkodër.</p> <p>Stadiumi "Loro Boriçi" është pasuri e paluajtshme, pronë publike, në pronësi të Bashkisë Shkodër. Kjo pronë ka kaluar në pronësi të Bashkisë Shkodër me VKM nr. 421, datë 2.6.2010 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, Qarku Shkodër", me nr. 221 rendor në listë të inventarit.</p> <p>Këshilli Kombëtar i Territorit të Republikës së Shqipërisë me Vendimin nr. 1, datë 1.4.2015 ka miratuar kërkesën e Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF) për të investuar në rikonstruksionin e këtij objekti. Përfitues i këtij investimi është Bashkia Shkodër. FSHF dhe Bashkia Shkodër kanë nënshkruar një Marrëveshje (Nëntor 2015) me qëllim bashkëpunimin për rikonstruksionin, përdorimin dhe manaxhimin e këtij impianti sportiv në pronësi të Bashkisë Shkodër pas realizimit të konstruksionit të Stadiumit "Loro Boriçi".</p> <p>Me datë 06.03.2019 në prani të personit të autorizuar nga Bashkia Shkodër u dorëzua nga personi i autorizuar nga FSHF dokumentacioni original: Relacion përmbljedhës i mbikëqyrësit të punimeve, Situacion përfundimtar i punimeve, Akt kolaudimit përfundimtar të projektit, Shkresë nga UEFA ku stadiumi plotëson standartet e kategorisë 4, Certifikatë e përhershme e marrjes në dorëzim, Libreza e masave dhe vizatime të stadiumit final.</p> <p>Të gjitha institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore krijojnë kushtet e nevojshme që nxënësit, studentët, efektivat e policisë dhe të Forcave të Armatosura të zhvillojnë veprimtari fizike dhe sportive, individuale dhe/ ose të organizuara. Njësia administrative e pushtetit vendor harton dhe garanton politikën vendore në fushën e sportit shkollor, sportit për të gjithë dhe sportit elitari, krijon institucione përgjegjëse për sportin, menaxhon objektet sportive, që ka në pronësi, ndërton objekte të reja, sipas nevojës, mbështet zhvillimin dhe veprimtarinë e organizatave sportive që zhvillojnë veprimtari në territoret e tyre. Bashkia Shkodër ka filluar procedurën për marrjen në dorëzim të punimeve të objektit të Stadiumit "Loro Boriçi" dhe mirëmbajtjen e tij. Janë kryer pagesat për shërbimin e rojeve dhe pagesat për shërbimet utilitare të tij.</p> <p>Fusha sportive "Reshit Rusi" është një nga infrastrukturat sportive në pronësi të Bashkisë Shkodër ku zhvillohen trajnimet dhe ndeshjet e akademisë së futbollit, për ekipet e grupmoshave si dhe për zhvillimin e ndeshjeve futbolistike sidomos në rastet kur luajnë moshat. Dhe ka nevojë për një rikonstruksion të përgjithshëm si objekt për t'iu përgjigjur standarteve bashkëkohore sportive.</p> <p>Në këto terrene janë të punësuar 31 punonjës: përgjegjës në menaxhimin e punëve të përditshme, magazinier, teknik mirëmbajtjeje si të rjetit elektrik ashtu dhe atij hidraulik, punëtorë terreni sportiv që kujdesen për ujitjen e pastrimin e tij, sanitare/ punonjës të mirëmbajtjes së higjienës, dhe shërbim të rojes tek fusha e lëkurave "Reshit Rusi". Këta punonjës, janë në shërbim të mirëadministrimit të kësaj infrastrukture sportive, si punonjës në strukturë të Bashkisë Shkodër.</p>		
ii. Synimi i projektit		
<ul style="list-style-type: none"> • Garantimi i kushteve në stadiumin "Loro Boriçi", në fushën sportive "Reshit Rusi" dhe pallatin e sportit "Qazim Dervishi" Shkodër në përputhje me standardet e FIFA, UEFA dhe Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, • Rritja e cilësisë sportive të futbollit të qytetit të Shkodrës • Organizimi i aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare të futbollit dhe të sporteve të tjera në këto objekte sportive. 		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
